



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 74/₂ prot.

Tiranë 24 . 01 . 2026

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORË

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) në mbështetje Ligjit nr.69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; të VKM, nr. 98, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)”; dhe të rregullores së brendshme nr. 492, datë 30.07.2020 “Për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm”; në zbatim të planit të veprimtarive të ASCAP-it për vitin 2026, shpall thirrjen për bashkëpunëtorë që mund të angazhohen në lidhje me: hartimin e kuadrit rregullator që lidhet me funksionimin e brendshëm të institucionit dhe zbatimin e planit të integritetit, hartimin e raporteve përkatëse, hartimin dhe përditësimin e dokumenteve dhe raporteve lidhur me sistemin arsimor parauniversitar, produktet që lidhen me masat e planifikuara në dokumentin e planit të veprimit të arsimit digjital 2025-2030, hartimin e kuadrit metodologjik për sistemin kombëtar të vlerësimit të shërbimit psiko-social, si dhe dokumente të tjera sipas veprimtarive të planit vjetror të Institucionit për vitin 2026.

Bashkëpunëtorët duhet të përmbushin këto kërkesa:

1. Të kenë mbaruar arsimin e lartë me kohë të plotë në një nga degët: Shkenca Edukimi, Shkenca Informatike, Shkenca Ekonomike ose Shkenca Juridike.
2. Të kenë të paktën 5 vjet eksperiencë pune në arsim ose në profilin përkatës.
3. Të kenë aftësi bashkëpunuese dhe aftësi të punës në grup.
4. Të kenë njohuri në gjuhë të huaj (preferohet gjuha angleze).
5. Të përdor kompjuterin.
6. Kërkesa të vecanta:
 - Përvojë në hartimin dhe shkrimin e raporteve dhe komunikimin e gjetjeve në mënyrë të qartë dhe koncize;
 - Përvojë e mëparshme në mësimdhënie ose administrim arsimor, si dhe në hartimin ose vlerësimin e politikave arsimore;
 - Certifikata kualifikimi / certifikata trajnimi ose të ngjashme;
 - Bashkëpunime me ASCAP-in dhe institucione të tjera të varësisë së MA-it, për realizimin e veprimtarive të tyre në mbështetje të edukimit në arsimin parauniversitar;
 - Njohuri të mira mbi politikat dhe praktikat arsimore në nivel kombëtar dhe evropian;

- Njohuri mbi administrimin dhe mirëmbajtjen e platformave digjitale;
- Aftësi për të kryer kërkime të thelluara dhe të përshtatjes së platformave digjitale në procesin arsimor;
- Aftësi për të identifikuar dhe zbatuar masat të sigurisë digjitale;
- Aftësi për hartimin e formateve standarde për praktika të thjeshta pune;
- Aftësi për hartimin planeve dhe raporteve që lidhen me transparencën;
- Njohuri të mira mbi funksionimin e institucioneve shtetërore me prioritet ato arsimore, lidhur me legjislacionin arsimor;
- Njohuri të mira në analizën statistikore dhe përpunimin e të dhënave duke përdorur programet kompjuterike dhe aftësi të mira digjitale.

Kandidatët duhet të dorëzojnë fotokopje të dokumentit të identitetit, CV-në, fotokopje të diplomës, fotokopje të certifikatave të trajnimit apo kualifikimit, si dhe cdo dokument tjetër që vërteton kriteret e vecanta, pranë sekretarisë së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP), në adresën: *Rruga "Naim Frashëri", Nr.37, Tiranë*, ose me e-mail sekretaria@ascap.edu.al brenda datës 04.02.2026, ora 16.30.

Do të njoftohen vetëm kandidatët e përzgjedhur.

Faleminderit!